

Silogjizmi i Thjeshtë – Argumenti formal

grc. συλλογισμός **sullogismós** (inferencë, përfundim). Etimologjia e lashtë e fjalës infer(encë) vjen prej para-indo-europjanishtes *b^héreti ‘me bartë’ < *b^her-. Në silogjizëm, argumenti *çohet përpara*, ose *bartet*—prej premisave te përfundimi; nëse përmbajtja e premisave përkon me botën reale. Këtu mund të vërehet ngjasia e silogjizmit me dialektikën, e cila gjithashtu përparon drejt qartsmit të argumentit. Të dyja kërkojnë të vërtetën pavarësisht prej ndjenjave të audiencës (retorikës) apo kohës, situatës, e rrethanave (kairos) ku jepet kumti. Në këtë aspekt, ato ndryshojnë prej enthemimës, e cila mbetet e ngujuome në audiencë dhe rrethana.

Abstrakti

Ky artikull trajton strukturën dhe funksionin e silogjizmit të thjeshtë si themelet e argumentit formal, çka e dallojnë atë prej dialektikës hegeliane e platonike. Për shembull, ndërsa dialektika kërkon të vërtetën përmes ballafaqimit të kundërshtive, silogjizmi e kërkon atë përmes logjikës deduktive, domethanë përfundimi rrjedh nevojësisht prej dy premisave të dhana.

Punimi analizon rregullat teknike që e bëjnë një silogjizëm të vlerët, me fokus të veçantë te roli i “termi të mesëm” që lejon kalimin logjik prej të përgjithshmes (premisës së madhe) te e veçanta ose faktikja (premissa e vogël). Duke u mbështetur në traditën aristoteliane, artikulli argumenton që silogjizmi nuk është një formulë e thjeshtë mekanike, por një mjet thalbsor që garanton vërtetësinë e mendimit dhe një antidotë kundër sofizmave në diskursin filozofik dhe shkencor.

Fjalët Kyçe

silogjizmi kategorik, premisa e madhe, premisa e vogël, përfundimi, termi i mesëm, logjika formale, eduksoni, vlerësimi logjike

Njohuni Paraprake

1. Asertat duhet të mbështeten në evidencë, p.sh., merr aserten: *Akulloret janë të shëndetëshme*.

S’pari duhet me qartsua çka kihet parasysh me fjalën ‘akullore’, pastaj duhet dhanë evidenca që mbështetë argumentin e përmbajtun në asertë. Në qoftë se evidenca nuk jepet, ndërkumtuesi pyetë: *Çfarë evidence e mbështetë këtë deklaratë?* Pastaj, evidenca dhe argumenti duhet të lidhen me njëna-tjetrën në mënyrë të arsyeshme.

Besimi në një argument mund të influencohet prej bindjeve të ekspertëve dhe përvojës së argumentuesve, por në fund të fundit, pavarësisht prej ekspertizës, përvojës, a karakterit

të folësit, argumenti duhet të mbështetet në evidencë *korrekte, të lidhura me subjektin në fjalë, të mjaftueshme, të larmishme*, dhe në arsyetim të shëndoshë.

2. Argumenti është një përfundim që mbështetet në atë që thohet më parë. Për shembull, argumenti i masipërm mbështetet në të vërtetat që e mbështesin atë; dhe të cilat mund të dalin pas fjalësh si ‘sepse’. Për shembull, *Akulloret janë të shëndetëshme sepse...* Asertat që pasojnë fjalë të tilla kanë funksion mbështetës. Por edhe të vërtetat e tyre duhet hulumtua.

3. Duke krahasua asertat që *tregojnë bindje* me asertat që *mbështesin bindjet*, vërehet që argumenti ndërtohet prej dy farë asertash, secila me funksion krejtisht të ndryshëm prej tjetrës:

a) Asertat a deklaratat mbështetëse, të cilat quhen **premissa**.

b) Një deklaratë që mbështetet në deklarata të tjera dhe e cila quhet **përfundim**.

Silogjizmi ka një a më shumë premisa, por ai ka vetëm një përfundim.

Premisat ndahen në *premissa të mëdha (pm)* dhe *premissa të vogla (pv)*. Rendi i i tyre nuk ka rëndësi, por ato duhet të jenë qartsisht të tilla.

Premisa e madhe jep *të përgjithshmen*.

Premisa e vogël jep *të veçantën ose faktiken*.

Propozimi & Premisa e Përfundimi

Në shembujt e masipërm duket sikur ka paqartësi në mes të termave: *propozim, premisë, dhe përfundim*. Në vetvete, propozimet nuk janë as premisa as përfundime. Por, kur propozimet përdoren me ndërtua silogjizmin, ato quhen premisa (2 sosh) ose përfundim (1 sosh).

Deklaratat e Thjeshta dhe Kushtore

Deklaratat e thjeshta dhe kushtore nuk janë argumente. Të parat mund të përdoren me dhanë informacion, p. sh.,

Filja ndezij¹ kerrin.

Të dytat mund të përdoren me tregua që X nuk mund të ndodhi pa u përmbushun kushti Y, p. sh.,

Në qoftë se Filja ka çilësin, ajo do të ndezij kerrin.

¹ Është interesant se në shqip thohet: ndezi zjarmin, ndezi makinën. Krahasoje me anglishten, *lit a fire (ndezij zjarmin), sat on fire (i vuni zjarmin), turned on the car (ndezij kerrin)*.

Disa Tregues Logjikë

Treguesit logjikë janë fjalë që sinjalizojnë se çka pason pas tyre. Ata ndahen në dy kategori:

tregues premisash: *sepse, për këtë arsye, ndërsa, siç tregohet, ja faktet*

tregues përfundimi: *prandaj, kështu, si rezultat, tregon se, mund të inferojmë se, mund të përfudnojmë se*

Kështu, pas termash si ‘sepse’, pritet një premisë. Kurse pas termash si ‘prandaj’ pritet një përfundim

Narrativi/rrëfimi nuk është argument

Nëpërmjet teknikave narrativiste, rrëfimi mund të formulojë një argument, p.sh., ‘Besa është barrë e vështirë’ Por argumenti i rrëfimit është jodirekt. Ai mund të nxirret vetëm nëpërmjet analizës së rrëfimit.

Dallimi i Silogizmit prej Enthemimës

Silogizmat, të cilat janë baza e argumentit deduktiv, kanë tri propozime (dy premisa dhe një përfundim). Enthemimat kanë dy propozime, tipikisht një premisë dhe përfundimin, por ka herë që ato mund të kenë edhe vetëm dy premisa. Prejse propozimi që mungon në enthemimë nënkuptohet, ai mund të qitet në pah dhe kështu vlera e enthemimës mund të gjykohet nëse ajo përban një silogizëm të vlerhtë.

Një *enthemimë* me dy propozime (një premisë dhe një përfundim):

Marini do t'i sjellë Files lule sepse sot është datlindja e saj.

Një *silogizëm* me tri propozime (dy premisa dhe një përfundim):

premissa 1 (*e përgjithëshmja*): *Çdo datlindje, Marini i sjellë Files lule.*

premissa 2 (*fakti, e veçanta*): *Sot është datlindja e Files.*

Përfundimi: *Prandaj, Marini do t'i sjellë Files lule.*

Nëpërmjet kthimit të saj në silogizëm mësojmë që kësaj enthemime i mungon premisa 1 (premissa e madhe).

Formalisht, ky silogizëm është i rregullt: pm + mv + pf (premissa e madhe + premisë e vogël + përfundim). Por materialisht, domethënë nëse ajo që thohet në premisa përkon me botën reale, mund duhet më shumë evidencë. Për shembull, 1) a harron Marini ndonjë herë me i sjellë Files lule për datlindjen e saj, dhe 2) A është me të vërtetë datlindja e Files sot? 3) Si mund të zgjidhet çështja sikur Filja të ishte lemë më 29 shkurt?

Paraqitje

Silogjizmi mund të ndahet në katër tipe, 1) i thjeshtë, 2) hipotetik, 3) disjunktiv, dhe në 4) dilemë. Më poshtë diskutohet *vetëm silogjizmi i thjeshtë*.

Silogjizmi i thjeshtë

Silogjizmi përmban tri propozime: *dý premisa + një përfundimin*. Premisat ndahen në *e madhe* (en. major) dhe *e vogël* (en. minor). Secila premisë përmban një term të veçantë dhe një term të përbashkët. Ky i fundit quhet *termi i mesëm*. Ai nuk mund të përdoret në përfundim. Kështu, silogjizmi ka tri terma:

- të madhin (*në premisën e madhe; përdoret në përfundim*)
- të voglin (*në premisën e vogël; përdoret në përfundim*)
- të mesmin (*në secilën premisë; nuk përdoret në përfundim*)

Secili propozim i silogjizmit ka dy terma:

Premisa e madhe: *termin e madh dhe termin e mesëm*.

Premisa e vogël: *termin e vogël dhe termin e mesëm*.

Përfundimi: *termin e vogël^(subjekti) dhe termin e madh^(predikati)*

Në shembujt pasues: **s** = subjekti/kryefjala; **f** = folja këpujore/lidhëse; **p** = predikati/kallzuesi

Silogjizmi nuk quhet as i vërtetë as i rremë (fallso). Ai quhet i vërtetë (en. valid) ose i pavërtetë (en. invalid).

Premisa **e madhe** përmban një asertë ose deklaratë *të përgjithëshme*.

Tan njerëzit^s janë^f vdektarë^p.

Premisa **e vogël** përmban një asertë ose deklaratë *specifike*.

Sokrati^s është^f njeri^p.

Përfundimi pason nevojshet prej marrdhanjes së premisë së madhe me premisë së vogël:

Sokrati^s është^f vdektar^p.

1. Në këtë shembull,

Premisa e madhe përmban *termin e madh* (en. major) ‘vdektar’.

Premisa e vogël përmban *termin e vogël* (en. minor) ‘Sokrati’.

Termi ‘njerëzit’ quhet *termi i mesëm* (en. middle term). Ai nuk del në përfundim, por është jashtzakonisht i randësishëm sepse ai shërben si lidhja logjike, ura, në mes të termit të madh dhe të vogël, dhe si rezultat, në nevojson logjikisht përfundimin.

Tan njerëzit^(termi i mesëm) janë^(f) vdektarë^(termi i madh).

Sokrati^(termi i vogël) është^(f) njeri^(termi i mesëm).

Prandaj, *Sokrati*^(subjekti/termi i vogël) është^(f) vdektar^(predikati/termi i madh).

Në këtë silogjizëm, tan njerëzit përfshihen në termin e përgjithëshëm ‘vdektarë’. Sokrati, si njeri i veçantë, përfshihet në termin ‘tan njerëzit’, domethanë, ajo që ndodhë te çdo njeri ndodhë edhe te ai. Kështu, termi i mesëm (njerëzit/njeri) shërben si lidhje logjike në mes të vdektarëve (njerëzve) dhe Sokratit (njeriut të veçantë). Në qoftë se të gjithë njerëzit janë vdektarë dhe Sokrati është njeri, është logjikisht e nevojshme që edhe Sokrati të jetë vdektar; sepse ai është njeri.

Të vërtetat e premisave nuk janë dituni e ré, dhe asnjëna sosh nuk e përmban të vërtetën e përfundimit. E vërteta e përfundimit është një dituni e ré që nënkuptohet dhe mundsohet prej lidhjes së dy premisave. Kështu, ndërsa premisat e riorganizojnë ose etiketojnë dituninë rreth botës pa shtua gjë të ré, përfundimi shton dituninë të ré rreth botës. Kështu, nëpërmjet arsytimit, mësojmë diçka që as nuk është dituni a randomtë as nuk mund të shqisohet.

Përmbledhje

Elementi	Roli në Diskurs	Shembull
Termi i mesëm	Ura e logjikës	<u>njerëzit</u> (lidhë Sokratin me vdektarët)
Premisa e madhe	Regulli universal	<i>Tan njerëzit janë vdektarë.</i>
Premisa e vogël	Fakti specifik	<i>Sokrati është njeri.</i>
Përfundimi	Dija e ré	<i>Prandaj, Sokrati është vdektar.</i>

2. Kur forma është *joproblematike*, argumenti quhet *i vlerëtë* (en. *valid*). Kur forma është *problematike*, argumenti quhet *i pavlerëtë* (en. *invalid*). Argumenti quhet **i vlerëtë** vetëm-nëse përfundimi bartet nevojshisht prej premisave.

3. Analiza e silogjizmit nisë prej përfundimit, ku termi i vogël (en. *minor*) është subjekti i përfundimit dhe ku termi i madh (en. *major*) është predikati i përfundimit.

Materia e silogjizmit janë propozimet.

Forma e silogjizmit është nevoja logjike e përfundimit.

Format Standarde të Deklaratave Kategorike

Në logjikën formale (silogjizëm), forma e përfundimit është gjithmonë: **Subjekt** [A E I O] **Predikat**. Këto shkronja përfaqësojnë katër format standarde të deklaratave kategorike, të cilat u patën standardizuar prej Aristotelit dhe pastaj u patën shvilluar më tej prej skolastikëve të mesjetës përmes *Katrorit të Kundërshtive*. Germat janë mënyra me mbajtje mend kategoritë. Ato janë marrun prej fjalëve latine:

AffIrmo (Un pohoj) dhe **nEgO** (Un mohoj).

	Lloji	Struktura	Shembull
A	e përgjithëshme pohuese	Çdo S është P.	<i>Tan njerëzit janë të vdekshëm.</i>
E	e përgjithëshme mohuese	Asnjë S nuk është P.	<i>Asnjë njeri nuk është i pavdekshëm.</i>
I	e veçantë pohuese	Disa S janë P.	<i>Disa njerëz janë shqiptarë.</i>
O	e veçantë mohuese	Disa S nuk janë P.	<i>Disa njerëz nuk janë shqiptarë.</i>

Disa sunde e presa

1. Silogjizmi përmban **vetëm tri** terma: *të madhin, të voglin, të mesmin*.
2. Termi i mesëm duhet të **shpërndahet** (tan... asnjë...) së paku në njënën prej premisave.
3. Nuk mund të nxirret përfundim prej dy premisash negative, sepse në këtë përdorim, asnjëna prej dy termave nuk mund të lidhet me termin e mesëm; pa termin e mesëm nuk mund të ketë përfundim të nevojshëm logjik.
4. Në qoftë se njëna primisë është mohore, edhe përfundimi duhet të jetë mohor.
5. Nuk mund të nxirret përfundim prej dy premisash të pjesëshme ose kontingjente.
6. Në qoftë se një premisë është e pjesëshme, edhe përfundimi duhet të jetë i pjesëshëm.
7. Në qoftë se një premisë është kontingjente, edhe përfundimi duhet të jetë kontingjent.
8. Në qoftë se njëna ose të dy premisat janë empirike, edhe përfundimi duhet të jetë empirik.
9. Një silogjizëm nuk mund të kate katër terma.

Modaliteti

Katër format e propozimit (*A E I O*) japin 16 kombimime propozimesh:

AA, AE, AI, AO, EA, EE, EI, EO, IA, IE, II, IO, OA, OE, OI, OO

Duke u bazua në sundet e masipërme, të cilat nuk janë krejt të plota, disa kombimime japin argumente *nevojsisht të vlerata*, kurse disa të tjera japin argumente *nevojsisht të pavlerata* (falsitete logjike).

Figurat

Figurat bazohen në vumjen, ose pozicionin, e termit të mesëm. Nuk ka randësi se cila premisë vendoset e para.

Egzistojnë katër figura:

m – termi i mesëm; **s** – subjekt/kryefjalë; **p** – predikat/kallzues

	Vendi i Termit të Mesëm	Përshkrimi i Pozicionit të Termit të Mesëm
I	M — P S — M	<i>Termi i Mesëm është:</i> Subjekt në të parën, Predikat në të dytën.
II	P — M S — M	<i>Termi i Mesëm është:</i> Predikat në të dyja premisat.
III	M — P M — S	<i>Termi i Mesëm është:</i> Subjekt në të dyja premisat.
IV	P — M M — S	<i>Termi i Mesëm është:</i> Predikat në të parën, Subjekt në të dytën.

Modus Ponens

Modus ponens është një formë argumenti deduktiv në logjikën propozicionale; një tip inference që mund të nxirret prej një propozimi hipotetik. Latinizma ‘modus’ përkthehet si *mënyre* ose *metodë*, dhe latinizma tjetër ‘ponens < ponere’ përkthehet si pohim (afirmim). Kështu, ‘modus ponens’ do të thotë **metodë** ose **mënyrë pohimi**.

Në qoftë se P, atëherë Q

P

Prandaj, Q.

1. Modus ponens mund të ndahet në dy pjesë: *paraardhësi* (antecedenti) dhe *pasardhësi* (konsekuenti).

- paraardhësi - propozimi i parë; deri para fjalës ‘atherë’
- pasardhësi - propozimi i dytë; duke nisë me fjalën ‘atherë’.

2. Modus ponens mund të **pohojë** propozimin paraardhës.

deklarata kushtore: Në qoftë se P, atëherë Q.

pohimi i paraardhësit: P

përfundimi: Prandaj, Q.

Premisa kushtore pohon se *në qoftë se P* është e vërtetë, edhe Q është e vërtetë. Vërtetsia e P pohohet në premisën e dytë, ndërsa vërtetsia e Q nxirret si përfundim.

Premisa 1. *Në qoftë se P është e vërtetë,*

atherë edhe Q është e vërtetë.

Premisa 2. *P (është e vërtetë).*

Përfundimi. *Prandaj Q.*

Shembull:

*p1: Në qoftë se je 18 vjeç (P),
atherë mund të votosh (Q).*

p2: Je 18 vjeç (P).

pf: Prandaj, mund të votosh (Q).

Këtu argumentohet që mund të votosh sepse përmbushë të vetmin kusht që kërkohet prej ligjit; të qenunit 18 vjeç

Falsiteti i pohimit të pasardhëses

Falsiteti i pohimit të pasardhëses

Në qoftë se P, atherë Q

jo-Q

Prandaj, jo-P

Shembull:

*p1: Në qoftë se je 18 vjeç (P),
atherë mund të votosh (Q).*

p2: Nuk mund të votosh (jo-Q).

pf: Prandaj, nuk nuk je 18 vjeç (jo-P).

Ky argument është i pavlertë sepse arsyeja përse një person nuk mund të votojë mund të mos lidhet me moshën.

Modus Tollens

Latinizma tollens < tollere do të thotë ‘me mohua, me hjekë, me asgjâsua’. Kështu, modus tollens do të thotë **metodë** ose **mënyrë mohimi**.

Sipas modus tollens, në qoftë se një shkak (en. cause) gjithmonë çon në një pasojë (en. effect), atherë, kur mungon pasoja mungon edhe shkaku.

Në qoftë se P, atherë Q

jo-Q

Prandaj, jo-P.

Në këtë metodë, $P = Q$. Por, prejse Q mohohet (jo-Q), atherë P nuk është e vërtetë (jo-P).

p1. Në qoftë se gota të bjen në tokë ,(P),
atherë ajo do të thehet (Q).

p2. Gota nuk t'u thye. (jo-Q)

pf. Prandaj, nuk të rá në tokë. (jo-P)

Këtu argumentohet që mosthyemja e gotës tregon që ajo nuk rá në tokë; jo që gota nuk u thye—ajo mund të thehet për arsye të tjera.

Falsiteti i mohimit të paraardhëses

Ky falsitet formulohet si më poshtë:

Në qoftë se P , atherë Q

jo-P

Prandaj, jo-Q

Shembull:

p1. Në qoftë se gota të bjen në tokë ,(P),
atherë ajo do të thehet (Q).

p2. Gota nuk të rá në tokë. (jo-P)

pf. Prandaj, gota nuk u thye. (jo-Q)

Ky argument asht i pavlertë sepse gota mund të thehet për arsye të tjera.

Silogizmi Disjunktë (i ndamjes ose veçues)

1. S'pari dý terma duhen kuptua dý terma.

a) **me vendua** (en. to posit; lat. positus < pōnō *me vû, me vendua, me vendosë*): me supozua që diçka është e **vërtetë**; *me e ri-deklarua atë si fakt*.

b) **me kundërshtua** (en. to sublate – to deny, negate, contradict); me mohua a me asgjësua një mundësi; me rideklarua të kundërtën e saj si fakt.

english	Termi	Funksioni Logjik
to posit	me vendua / me vû	pohim (afirmim)

to sublate me kundërshtua / me asgjësua mohim/heqje (negacion)

Në këtë Silogjizëm, **premissa e madhe** është një propozim disjunktiv (disjunktë), kurse **premissa e vogël** është një *propozim i thjeshtë* kategorik që pohon ose mohon njënen prej alternativave.

	Në Premisë	Në Përfundim	Shpjegimi
ponendo tollens	pohim (posit)	mohim (sublate)	Duke pohua, kundërshton.
tollendo ponens	mohim (sublate)	pohim (posit)	Duke kundërshtua pohon

Ponendo tollens (mohon duke pohua)

Këtu premissa e vogël *vendon (supozon të vërtetë) njënen alternativë,*

course

përfundimi *kundërshton (en. sublate) tjetrën alternativë.*

S është ose P ose Q: *Prela është ose në bjeshtë ose në Velipojë.*

S është P: *(vendon/supozon të vërtetë) Prela është në bjeshtë.*

Prandaj, S nuk është Q: *(kundërshton) Prandaj, Prela nuk është në Velipojë.*

Tollendo ponens (pohon duke mohua)

Këtu, premissa e vogël *kundërshton (en. sublate) njënen alternativë,*

course

përfundimi *vendon (supozon të vërtetë) tjetrën*

S është ose P ose Q: *Prela është ose në bjeshtë ose në Velipojë.*

S nuk është Q: *(kundërshton) Prela nuk është në Velipojë.*

Prandaj, S është P: *(vendon/supozon të vërtetë) Prandaj, Prela është në bjeshtë.*

Rregulli i artë i silogjizmit disjunktë

Me qenë i vërtetë, silogjizmi disjunktë duhet me plotsua dy kushte, një për secilin tip. Kur kushtet nuk përmbushen, kemi falsitetin logjik të quajtur ‘dilema e rreme’, p.sh.,

S është ose P ose Q: *Prela është ose në bjeshtë ose në Velipojë.*

S nuk është P: *(kundërshton) Prela nuk është në bjeshtë.*

Prandaj, S është Q: *(vendon) Prandaj, Prela është në Velipojë.*

Ky argument është **i gabuom** sepse Prela mund të jetë në Shkodër.

a) Në *Ponendo Tollens*, alternativat duhet me qenë **përjashtuese**, p.sh., ose i gjallë ose i vdekun; ose njëna ose tjetra. Nëse pranohet ose vërtetohet njëna, tjetra duhet të mohohet.

Në shembullin e masipërm nuk është përcaktua që Prela mund të jetë **vetëm** në *bjeshkë* ose në *Velipojë*. Duke mos i përcaktua këto dy vende si të vetëmet, dhe prandaj që përjashtojnë njëna-tjetrën, mbeten të hapuna edhe alternative të tjera, p.sh., Shkodra. Prandaj ai argument është i gabuom; dilema është e rreme.

Në detë ka një zonë neutrale. Prandaj, nëse një anije po lundron në Adriatik, nuk mund të thohet që ajo është ose në anën e Italisë ose të Shqipnisë sepse anija mund të ishte në zonën neutrale.

b) Në *Tollendo Ponens*, alternativat duhet me qenë **shterruese**, p.sh., ose *cub* ose *parë* (en. odd or even); nuk mund të ketë zgjidhje të tretë.

Në shembullin e masipërm zgjedhjet nuk janë shterruese sepse ka edhe alternative të tjera, prandaj ai argument është i gabuom; dilema është e rreme.

Ky shembull kuptohet ma mirë nëpërmjet numrave. Ka vetëm dy kategori:

cub: 1, 3, 5, 7, 9, 11...

parë: 2, 4, 6, 8, 10 12

Cilindo numër që të zgjedhësh ai është ose cub ose parë.

Sorita – Silogizmi i Vargzuom

Imagjino një vargua të bamë me rrathë hekuri. Sikur njëni rreth të këputej, objekti që mund të varej në vargonj do të binte në tokë. Ose një shembull më i zakonshëm. Ndër Lekë përdoret fjala ‘qafzë’, një objekt që mbajnë gratë, veçsisht nusët, rreth qafës. Ky objekt mund të quhet edhe ‘vargj’ (në shumës). P. sh., *Ai i bleu të shoqes një palë vargj*. Tipikisht, vargjat janë të bamë me rrathë remi (en. copper), bronzi, argjendi, ose ari. Shpesh ndodhë që një rreth këputet. Kjo këputje shkakton ramjen e objektit që varet në vargj (ose qafzë).

Sikur në vend të rrathëve të vendosej një enthemimë ose një silogizëm, vargu do të quhej **soritë**. Sorita përkufizohet si një varg enthemimash, ku *termi i mesëm del në sosje të enthemimës majtas dhe nisë në nisje të enthemimës djathtas*. Kjo lidhje vazhdon prej në sosje të premisë së parë deri para përfundimit.

Sipas logjikës klasike, ka dy farë soritash. Të dyja kanë formën pasuese:

$$S \text{ (subjekt/kryefjalë)} > M_1 > M_2 > M_3 \dots P \text{ (përfundim)}.$$

Termat M qëndrojnë për term i mesëm. Numëri qëndron për rendin e termave.

1. *Sorita Aristoteliane (e përparme)*. Këtu niset prej prej përkufizimit më të ngushtuom, p.sh., *Sokrati*, dhe zbritet drejt përkufizimit më gjithpërfshisë, p.sh., *Substancë*. Termi i mesëm shërben si urë duke kalua prej predikatit (sosja) i një premise te subjekti (nisja) e tjetrës, p.sh.,

Sokrati (S) është njeri (M₁). Njeriu (M₁) është kafshë (M₂). Kafsha (M₂) është **substancë (P)**. *Përfundimi*: Sokrati (S) është substancë (P).

2. *Sorita Gokleniane (e prapme)*. Këtu renditja e premisave përmbysset. Prandaj, niset prej përkufizimit më gjithpërfshisë, p.sh., *Substancë*, dhe zbritet drejt përkufizimit më të ngushtuom, p.sh., *Sokrati*. Këtu kërkohet që predikati i premisë së parë të jetë subjekti i së dytës. Në shembullin pasues, termi ‘kafshë’ asht subjekti (kryefjala) i premisë së parë. (Këtu ky term funksionon si term i mesëm). Në premisën e dytë, termi ‘kafshë’ është predikati i fjalisë.

Çdo kafshë (M₂) është substancë (P). Çdo njeri (M₁) është kafshë (M₂). **Sokrati (S)** është njeri (M₁). *Përfundimi*: Sokrati (S) është substancë (P).

Shenim. Në të dyja tipet, nëse një premisë e vargut është e rreme (një rreth këputet në vargj), i tanë vargoni i arsyetimit këputet dhe përfundimi bjen.